



Projekti:

Mbështetja e Potencialit Rajonal të Turizmit

Objektiva e përgjithshme e projektit

Objektiva e përgjithshme e projektit është rritja e potencialeve turistike dhe promovimi i vlerave rajonale të zonës ndërkufitare dhe me konkretisht të punoj në:

- 1) Prezantimin e mundësive të reja turistike dhe rritjen e kualitetit të produkteve dhe shërbimeve
- 2) Zhvillimin e produkteve turistike konkurruese – promovim marketing për të tërhequr më shumë turist vendorë dhe të huaj

Objektivat specifike

- S01. Prezantimi i mundësive të reja turistike dhe rritja e kualitetit të produkteve dhe shërbimeve
- S02. Zhvillimi i produkteve turistike konkurruese – promovimi / marketingu për të tërhequr më shumë turistë vendorë dhe të huaj.

Pra, projekti do të nxisë rritjen e mëtejshme të turizmit duke ndikuar që turistët të kalojnë më shumë kohë në rajonin ndërkufitar dhe motivimin e një numri më të madh uristësh për të vizituar këtë rajon.

Rezultatet e pritshme ë projektit

- R 1: 20 rrugë të reja dhe një rrugë rajonale, të identifikuar dhe të zhvilluara të përfshira në një bazë të përbashkët të të dhënave.
- R 2: Objektet rurale dhe familjet përgjatë rrugëve turistike japin shërbime të kualitetit më të lartë, ato njihen dhe janë të mirëprezantuara tek turistët potencial.
- R 3: Kapacitetet e ciceronëve turistik ekzistues dhe potencial përmirësohen dhe përfaqësojnë personat kyç për zhvillimin e ardhshëm të produkteve të turizmit rajonal
- R 4: Tërheqja e vizitave të reja turistike, numri i vizitorëve është rritur, ekonomia e rajonit ka rritur biznesin dhe vlerat rajonale.

Grupet e synuara

Ofruesit e shërbimeve turistike, në veçanti ciceronët turistik ekzistues dhe të mundshëm, objektet e akomodimit, anëtarët e familjeve dhe pronarët e objekteve rurale. Përfituesit përfundimtarë: turistët vendas/të huaj, komunitetet rurale dhe banorët e tyre, Agjencia për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit, Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale, sipërmarrësit/investitorët, përpunuesit bimor/mjekësorë, restorantet, furnizuesit e shërbimeve, zejtarët / krijuesit brenda rajonit të Pollogut dhe Prizrenit.





Paketa e punës 1.

- A1.1. Identifikimi dhe përgatitja e ID-ve të 20 rrugëve turistike për të dy anët e zonës ndërkufitare dhe një rruge rajonale;
- A1.2. Shënimi GPS i shtigjeve / rrugëve turistike të identifikuara; Shenjimi nga bjeshkatarët dhe vendosja e shenjave në rrugët e sapo identifikuara dhe tashmë të shënuara në GPS;
- A1.3. Përgatitja e bazës së përbashkët të të dhënave me përmbajtjen e ID-ve të rrugëve turistike dhe koordinatat e skanuara të GPS;

Paketa e punës 2.

- A2.1 Identifikimi dhe shenjimi i objekteve rurale dhe familjeve (përshkrim i shkurtër dhe koordinatat e tyre GPS) përgjatë shtigjeve / rrugëve të skanuara turistike.
- A2.2 Vlerësimi i nevojave për trajnim, të objekteve rurale dhe përfaqësuesve të ekonomive familjare për zhvillimin e programit të mbështetjes këshilluese;
- A2.3 Zhvillimi dhe zbatimi i programit për mbështetje këshilluese

Paketa e punës 3.

- A3.1 Vlerësimi i nevojave për trajnimin e ciceronëve turistik potencial dhe ekzistuese për zhvillimin e programit të trajnimit për aftësi të buta;
- A3.2 Zhvillimi dhe zbatimi i programit të trajnimit për ciceronët turistik;
- A3.3 Zhvillimi dhe botimi i manualit për ciceronët turistik dhe animatorët;

Paketa e punës 4.

- A4.1. Dizajnimi, lëshimi i web-faqes moderne për promovimin e turizmit rural "Zbuloni zonën e Maleve të Sharrit";
- A4.2. Transferimi i pronësisë së platformës dhe udhëzimi i administratorëve të web-it për azhurnimin dhe mirëmbajtjen e platformës;
- A4.3. Hartimi dhe zbatimi i fushatës promovuese që do të promovojë faqen e internetit, shtigjet / rrugët, trashëgiminë kulturore dhe natyrore dhe ofruesit e shërbimeve që lidhen me shtigjet / rrugët.
- A4.4. Ngjarja përfundimtare - konferenca përfundimtare e shtypit;



Center for Sustainable Development ALKA Shogata Alpinistike Marimangat e Pejes
Bul. Partizanski Odredi 62-1/16
1000 Skopje Macedonia
alka@alka.org.mk www.alka.mk

building 2, No.8 10000 Pristina
www.marimangat.org



Ky publikim është përgaditur me ndihmën e Unionit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorevë dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton opinionin e Unionit Evropian".